



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 23/11 Prot.

Tiranë, më 30.04.2017

V E N D I M

Nr. 48 Datë 30.04.2017

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A LUSHNJË “MBI “PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”, të ushtruar në Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Lushnjë për periudhën e veprimtarisë 01.09.2015 deri më 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Administratori i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lushnjë, nuk i ka trajtuar me korrektesë rekomandimet e KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2016 Konkretisht:

Nga 36 masa organizative të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 2, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 20 dhe nuk janë zbatuar 12. Nga 12 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara gjithsej, është zbatuar 1, është zbatuar pjesërisht 1, është në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 9.

Nga KLSH është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1119/108, datë 20.01.2017 dhe përsëri deri më datën 10.03.2017, datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk ka filluar zbatimi i masave të rekomanduara. Konkretisht është rikërkuar zbatimi i 11 masave organizative dhe 9 masave për shpërblim dëmi në vlerën 61,878,282 lekë. Në mënyrë të detajuar masat e rekomanduara janë pasqyruar në shkresën përcjellëse nr. 1119/108, datë 20.01.2017, protokolluar në UK Lushnjë me nr. 151/3 prot, datë 24.01.2017.

Është ezauruar vetëm masa “Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet vlera 113,400 lekë, që përfaqëson shpenzim për drekë festive të Vitit të Ri, 2012 në vlerën 113,400 lekë. Ky shpenzim është kryer në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 849, datë 06.12.2012, për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtim”, *pasi* departamenti i financës ka bërë prezent argumentet e saj ligjorë dhe ka paraqitur prova të reja shkresore me të cilat nuk është njohur më parë grupi i auditimit.

Mos zbatimi i rekomandimeve është në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, çka ngarkon me përgjegjësi A. D. me detyrë administrator të shoqërisë, i cili me veprimet dhe mosveprimet e Tij, ka realizuar mospërbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë” dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 61,878,282 lekë, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

-Këshilli Administrativ të shqyrtojë vlerën **61,878,282 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2016 dhe nr. 1119/108, datë 20.01.2017. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Në rast mos-zbatimi të këtij rekomandimi, KLSH do të denoncojnë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë preken e interesave ligjshme të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Lushnjë Sh.a dhe të Shtetit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

II. Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës (Administrativ) dhe Administratorit, ligjshmëria e vendimeve të marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Situata ekonomiko-financiare e shoqërisë është shqetësuese, si dhe kapitali i shoqërisë ka kaluar në vlerë negative. Kjo shoqëri rezulton me humbje që nga viti 2012-2016, si dhe pritshmëri me humbje për vitin 2017, si dhe ka barrën e shlyerjes së kredive në vlerën 6,401,626 euro, pa përfshirë interesat.

Nga administratori i shoqërisë nuk është dhënë informacion i detajuar organeve drejtuese (Këshillit Mbikëqyrës (Administrativ) dhe Asamblesë së Përgjithshme, për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 15, dhe nenin 18.

-Nga organet drejtuese (Administratori, Këshillit Mbikëqyrës dhe/ose Administrativ, Asambleja e Përgjithshme) nuk është analizuar situata financiare dhe nuk është marrë asnjë vendim, edhe pas prezantimit të kësaj situate nga KLSH, ku raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2015, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....në kushte ekonomiko financiare të disfavorshme për shoqërinë (me humbje për vitet 2012,2013,2014 dhe e parashikuar me humbje për vitin 2015), si dhe me barrën e shlyerjes së kredive (dy kredi të tjera vetëm me pricipial 6,401,626 euro, pa përfshirë interesat), kjo shoqëri jo vetëm është në gjendjen e paaftësisë paguese, por është plotësisht e falimentuar bile në rastin më të keq, të një falimenti të provokuar, nga organet drejtuese të saj (këshilli mbikëqyrës, këshilli bashkiak dhe administratori i shoqërisë)”.

Duke rekomanduar

“Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive”.

“Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të shoqërisë Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë më datë 31.12.2015, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre”.

Për sa trajtua si më sipër

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime sha” Lushnjë, është në proces riorganizimi në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, ku shoqëria UK Lushnjë mbulon me shërbimin e furnizimit të ujit dhe largimin e ujërave të ndotura, ish-sha Lushnjë, si dhe komunat Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj. -Akoma nuk është kryer transferimi i asetëve nga ujësjellësit të komunave Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj, në zbatim të vendimit nr. 104 datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak Lushnjë.

- Është hartuar statuti i shoqërisë me kapital të regjistruar 355,000,000, kapital i cili i përket vetëm shoqërisë Lushnjë, jo sipas ndarjes së re organizative në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, nuk ka përfshirë

kapitalin e komunave ish-Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj, në zbatim të vendimit nr. 104 datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak Lushnjë.

Vendimi i këshillit bashkiak nr. 104 datë 29.12.2016 dhe statuti, është bërë kur gjendja e kapitalit të shoqërisë është negativ. Në këto kushte nuk duhet të kishin filluar procedurat për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, duke anashkaluar parashikimin taksativ të nenit 107 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Konkretisht shoqëria në pasqyrat e vitit 2015 ka një humbje të mbartur në vlerën 170,077,526 lekë, e cila e mbledhur me humbjen e vitit në vlerën 32,653,578 lekë e redukton kapitalin e shoqërisë në **vlerën 169,606,330 lekë**. (Trajtuar më hollësisht në faqet 30-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme të analizohet situata ekonomiko-financiare e shoqërisë (humbje për periudhë viti 2012-2015, si dhe pritshmëri me humbje për vitin 2016, si barrën e shlyerjes së kredive në vlerën 6,401,626 euro, pa përfshirë interesat), si dhe të merret vendimi përkatës: Kërkimin e subvencioneve ose granteve nga Ministria e Linjës, zvogëlimi i kapitalit, riorganizimin në një formë tjetër e shoqërisë, ose prishjen e saj në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 136, pika 3 dhe nenit 154 pika ç. Vendimmarrja e organeve drejtuese dhe në veçanti e asamblesë, është e domosdoshme të kryhet referuar ligjit nr. 9220, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 104 “Fillimi i procedurave të falimentimit”.

Menjëherë

-Nga Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme të rishqyrtohet statuti i shoqërisë pasi përcakton një kapital të regjistruar në vlerën 355,000,000 lekë, kapital i cili i përket vetëm shoqërisë Lushnjë, jo sipas ndarjes së re organizative në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, nuk ka përfshirë kapitalin e komunave ish-Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj, në zbatim të vendimit nr. 104 datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak Lushnjë.

Brenda datës 30.06.2017

2. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi rezultoi se edhe pse këshilli mbikëqyrës ka kontraktuar ekspert të mirë të kontabilitetit, të cilët me kërkesë të administratorit kanë punuar për të gjetur boshllëqe ligjore për mos pasqyrimin e saktë të humbjeve në pasqyrat financiare. Kjo argumentohet me faktin e vendosjes së normave të amortizimit menaxheriale, shumë të vogla nga A. D., pa miratim të këshillit mbikëqyrës dhe të asamblesë së aksionarëve për të ulur humbjen, pra pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (këshilli mbikëqyrës dhe asambleja e aksionareve), me një efekt financiar **në vlerën 220,827 mijë lekë, si dhe;**

-për vitin 2009 nga shoqëria nuk është llogaritur amortizim për projektin e kryer me bankën KFW.

-shoqëria në pasqyrat e vitit 2015 nuk ka paraqitur një kredi të kontraktuar në vitin 2012, në vlerën 1,800,000 euro duke mos dhënë një paraqitje të saktë e të besueshme të zërave kontabël.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 158, pika 3,c dhe ç, 4, 5, neni 16, pika 1,a, neni 167

“Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, neni 9, pika 1, neni 5, “Mbajtja e kontabilitetit”, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1.

-Humbjet e shoqërisë nuk do të ishin thelluar në atë masë, nëse ekspertët kontabël do të kishin kryer misionin e tyre me pavarësi dhe besnikëri ndaj ligjit. Ekspertët i kanë vlerësuar sipërfaqësisht pasqyrat financiare, dhe nuk kanë bërë analizë të plotë të instrumenteve të përdorur për të zvogëluar (fshehur) humbjen financiare dhe për të mos bërë transparencën e gjendjes financiare të shoqërisë, por vetëm me paratë e marra nga kjo shoqëri, kanë krijuar imazhin e certifikimit të pavarur të llogarive të shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Administrativ, të shqyrtohet raporti i ekspertëve kontabël dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës ndaj tyre, pasi me kërkesë të Administratorit këta ekspertë kanë punuar për të gjetur hapësira ligjore për mos pasqyrimin e saktë të humbjeve në pasqyrat financiare për periudhën 2009-2015, kanë vlerësuar sipërfaqësisht pasqyrat financiare, dhe nuk kanë bërë analizë të plotë të instrumenteve të përdorur për të zvogëluar (fshehur) humbjen financiare dhe për të mos bërë transparencën e gjendjes financiare të shoqërisë, por vetëm me paratë e marra nga kjo shoqëri, kanë krijuar imazhin e certifikimit të pavarur të llogarive të shoqërisë. Nëse ekspertët kontabël do të kishin kryer misionin e tyre me pavarësi dhe besnikëri ndaj ligjit, humbjet e shoqërisë nuk do të ishin thelluar në atë masë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës.

Menjëherë

III. Nga auditimi i hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lushnjë, nuk është aplikuar llogaritja e kamatë vonesave për mos likuidimin e faturave të ujit (si për ato që nuk janë likuiduar asnjë herë, të likuiduar pjesërisht, ose që nuk janë likuiduar në kohën e duhur). Konkretisht gjendja debitore nga mos arkëtimi i faturave të ujit të pijshëm më datën 31.12.2016 paraqitet në vlerën 236,650,348 lekë. Kjo gjendje debitore nuk ka përfshirë llogaritjen e kamatë vonesave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve”, Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si Titull Ekzekutiv”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7928, date 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar duke shkaktuar **te ardhura te munguara për shoqërinë në vlerën 23,650,348 leke** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet vlera **23,650,348 lekë**, që përfaqëson kamatëvonesa për mos likuidimin në kohë ose jo të faturave të ujit të

pijshëm, si dhe të merret vendimi përkatës për arkëtimin e kësaj vlere, pasi kjo përbën një të ardhur të munguar për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë.

Brenda datës 30.06.2017

2. Gjetje nga auditimi:

Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, nuk kanë analizuar shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe nuk kanë marrë masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë drejt rezultateve pozitive.

-Drejtorja e shoqërisë, nuk ka bërë një analizë të hollësishme të kostove operative, për të identifikuar mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, si dhe të uljes së çmimit për m³ ujë të prodhuar dhe të shitur.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka hartuar planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën, 2016. Ky plan duhet të përmbajë objektiva dhe masa konkrete, që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit, plan i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2017.

-Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk është bërë bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit 2016, humbjet nuk janë parashikuar të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka përcaktuar tarifën e prerjes, tarifën e rilidhjes, tarifa e vuloşjes së matësit dhe e penalteteve të tjera, tarifa të cilat duhet të përmirësonin faturën e ujit.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke përcaktuar afatin konkret të pajisjes së tyre 100 % me matës.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka bërë plotësisht evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuidojnë detyrimet përkatëse të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975 datë 21.11.2002 ”Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të hartojë dhe të miratojë një plan biznesi pesëvjeçar, ku të jenë pasqyruar tarifatat e reja në 5-vitet e ardhshme. Mbi bazën e këtij plani biznesi, duhet të zbatohet procedurat ligjore të miratimit të tarifave të reja të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, si dhe tarifave të tjera.

Brenda datës 31.08.2017

-Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

Brenda datës 30.06.2017

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të kostove operative për të identifikuar mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Shoqëria “Ujësjetellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të hartojë planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën 2017-2020. Ky plan të përmbajë objektiva dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit, plan i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2020.

Brenda datës 30.06.2017

-Nga Shoqëria “Ujësjetellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë për vitin 2017, të bëhet bilanci i ujit, analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

Brenda datës 30.06.2017

Shoqëria “Ujësjetellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të bëjë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke synuar që brenda vitit 2017, të bëhet pajisja 100 për qind e tyre.

Brenda datës 30.06.2017

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuidojnë detyrimet përkatëse të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e një rregullore të veçantë për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundravajtjes administrative si: Akt konstatimi, hartimi i procesverbaleve, vendosjen e gjobave, regjistrimi i gjobave, zyrat ku depozitohet akt konstatimi, gjoba, si dhe procedurat për arkëtimin e gjobave etj.

Brenda datës 30.06.2017

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për rritjen e transparencës ndaj klientëve, në lidhje me ankesat që kanë për mbi faturimet, verifikim të matësit të ujit etj, duke i trajtuar konform dispozitave ligjore për ankesat.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për të përcaktuar tarifën e prerjes, tarifën e rilidhjes, tarifën e vulosjes së matësit dhe të penalteteve të tjera, tarifa të cilat duhet të përmirësojnë faturën e ujit.

Brenda datës 30.06.2017

3. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi është konstatuar se 5500 copë matës inteligjent (elektronik) dhe të gjithë matësve të tjerë mekanik, të instaluar në apartamente, biznese dhe institucione, janë të pa kolauduar në momentin e vendosjes fillestare (paraprak) dhe periodike në kundërshtim me Ligjin nr. 9875 datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar, neni 27 dhe neni 28. Pra faturimi i sasisë së ujit të harxhuar në familjarë, biznese dhe institucione, nuk jep besueshmërinë mbi konsumin e ujit, si dhe bazuar direktivës ujëmatëse për instrumentet

ujëmatëse 7533 EC. Veprim që ngarkon me përgjegjësi A. D. me detyrë administrator i UK Lushnje, drejtorinë juridike dhe drejtorinë tregtare (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për kolaudimin e matësve në momentin e vendosjes fillestare (paraprak) dhe periodike, në mënyrë që të garantohet faturimi i drejtë i konsumit të ujit nga konsumatorët.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

IV. Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:

1.Gjetje nga auditimi:

-Për vitet 2015 dhe 2016, si rezultat i zgjidhjes të kontratës së punësimit (largimet nga puna), pa shkaqe të arsyeshme Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, është penalizuar nga vendimet e gjykatave në 1 rast në vlerën 351,009 lekë, nga e cila është disbursuar shuma totale prej 351,009 lekë (344,250 lekë punonjësi dhe 6,759 tarifë përmbarimi). Vlera totale prej **351,009 lekë përbën dëm ekonomik** për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi A. D. me detyrë Administrator për periudhën 23.08.2011 dhe në vazhdim dhe Shefin e Departamentit të Burimeve Njerëzore Sh.A.

-Shoqëria nuk disponon një procedurë ose rregullore të përcaktuar për rekrutimin e punonjësve, si edhe nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive. Nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja e punonjësve është bërë në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj, por procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qarte dhe transparente.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 55-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Brenda datës 30.06.2017

2.Gjetje nga auditimi:

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, derdhur në Institutin e Integritit të ish-të përndjekurve politikë, për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit

të ish-të përndjekurve politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2015-2016 **në vlerën 1,221,776 lekë**, çka ngarkon me përgjegjësi administratorin e shoqërisë A. D..

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti i Financës të merren masa për të derdhur **vlerën 1,221,776 lekë** për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë, në zbatim të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar”, detyrim i pa derdhur nga kjo shoqëri për vitet 2015-2016.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi është konstatuar se janë punësuar 11 punonjës me profesion elektrikistë/elektropompist, pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar, çka ngarkon me përgjegjësi administratorin e shoqërisë A. D. dhe shefin e Departamentit të Burimeve Njerëzore Sh.A. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për pajisjen e punonjësve me profesion elektrikistë/elektropompist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në përputhje me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”.

Menjëherë

V. Nga auditimi i mbajtjes së evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 71-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të zbatohen procedurat ligjore nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

Brenda datës 31.12.2017

2.Gjetje nga auditimi:

-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë. Megjithatë nga organet drejtuese te saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi , si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2015 është në vlerën 237,468,064 lekë, ndërsa për vitin 2016 është në vlerën 246,213,042 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 96% për vitin 2015 dhe 96% për vitin 2016, e zënë klientët për shitje uji.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2015, kjo gjendje paraqitet në vlerën 227,633,542 lekë dhe për vitin 2016, në vlerën 236,650,348 leke.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 94,632,481 lekë për vitin 2015 dhe në vlerën 129,671,914 lekë për vitin 2016.

Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 197% të të ardhurave për vitin 2015 dhe 244% për vitin 2016, ndërsa gjendja kreditore zë 62% të shpenzimeve për vitin 2015 dhe 87% për vitin 2016 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 71-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të Shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime” Sh.a Lushnjë më datë 31.12.2015 dhe 31.12.2016, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

Brenda datës 30.06.2017

3. Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria nuk ka një plan të aprovuar të llogarive kontabël nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme.

-Shoqëria nuk ka llogaritur asnjëherë provigjone për llogaritë e arkëtueshme. Nga totali i vlerës së llogarive deri më 30.11.2006, janë 61,888,281 lekë. Megjithëse kanë kaluar 10 vjet, nuk janë marrë masat për krijimin e provigjoneve për këto shuma. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3 “Instrumentet Financiare”, i përmirësuar.

Nga auditimi i kryer në aktivet afatgjata materiale u konstatuan mospërputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit në lidhje me klasifikimin e tyre. Nga ana e shoqërisë, zërat makineri e pajisje elektrike dhe elektronike nuk janë mbajtur në klasa të veçanta, por janë mbajtur në një grup me tubacionet dhe pusetat.

Shoqëria nuk disponon regjistrin kontabël të aseteve të shoqërisë në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Në klasën e ndërtesave u konstatua se godinat në sektorin e pompave në Konjat, janë me vlerë zero. Nga shoqëria nuk janë marrë masat për të kryer rivlerësimin e aseteve me vlera zero.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur, si dhe për të vepruar sipas me Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, për vlerësimin e tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqet 71-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Financës të marrin masa për aprovimin e planit kontabël të llogarive nga Këshilli Administrativ.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti i Financës, të marrin masa për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme, dhe ti propozojnë Këshilli Administrativ provizionimin e atyre klientëve të cilët nuk kanë shlyer detyrimet brenda afateve të caktuara.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti i Financës, të marrin masa për përgatitjen e regjistrit kontabël të aseteve të shoqërisë, si dhe për klasifikimin e aktiveve afatgjata materiale në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti i Financës, të marrin masa për evidentimin e linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, duke kryer kontabilizimin e tyre, si dhe vlerësimet për të proceduar sipas Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

VI. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

1.Gjetje nga auditimi:

-Në përcaktimin e fondit limit, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit".

-Në 2 raste, emrat e personave të njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk përputhjen me emrat e hedhur në sistemin elektronik të APP.

-Në tre procedura tenderimi, njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit, kërkesat për kualifikim, specifikimet teknike, ndërsa kriteret e vlerësimit nuk i ka përcaktuar.

-Në një procedurë tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

-Në një procedurë tenderimi, nuk është bërë lirimi i sigurimit të ofertës pas lidhjes së kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 18 "Sigurimi i ofertës".

-Në 13 raste, dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit, nuk është i plotë dhe i saktë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", vendimin nr. 862 datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor".

- Për procedurën "Rikonstruksioni i rrjetit ujësjellës të rrugëve nr. 1 "Llazar Bozo", nr. 2 "Papa Ilia Zagalli", nr. 3 "Estref Berati", në lagjen "Kongresi i Lushnjës", është copëzuar vlera e përllogaritur e materialeve të ndërtimit, duke i realizuar me procedurë "Blerje të

vogël", duke krijuar shmangie të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 28, pika 2, ku citohet se nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në ligj.

- Në 13 raste, shpenzimet e investimeve nga Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime" Sh.a Lushnjë, nuk disponojnë dokumentacionin se cilët punonjës punojnë në kantier, sipas rregullave të sigurimit teknik, nuk ka dokumentacion se cilët punonjës janë caktuar për të mbikëqyrur punimet. Nuk ka ndarje detyrash dhe nuk është caktuar ndonjë nëpunës i autorizuar për nxjerrjen e materialeve nga magazina. Nuk ka libër kantieri, fletë pune, ditar apo dokumentacion fotografik, mbi procesin e punës në kantier. Nuk ka afate të përcaktuara, se kur do fillojë e mbarojë investimi dhe nuk ka dokumentacion se kur kanë përfunduar objektet përkatëse të investimeve, në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

- Në 13 raste, shpenzimet e investimeve nga Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime" Sh.a Lushnjë, nuk është zbatuar VKM nr. 145 datë 26.02.1988 "Rregullore Higjieno-Sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", pika 3.4 "Projektet e ndërtimit", ku citon se projektet e ndërtimit të objekteve të reja, zgjerimi ose modifikimi i instalacioneve ekzistuese që shërbejnë për furnizim me ujë të popullatës, nuk lejohen të fillojnë pa miratimin me shkrim nga ana e ISSH dhe pikës 8, ku investimet nuk kanë të argumentuara kërkesat teknike dhe sanitare për rrjetin e ujësjetllës (Trajtuar më hollësisht në faqet 81-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" Sh.a Lushnjë, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të gjithë detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik si dhe në rregullat e prokurimit publik.

-Nga Administratori i Shoqërisë, t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

-Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim të investimeve në rrjetin e UK Lushnjë, duhet të planifikojë afatet e zbatimit të investimeve, plotësimin me dokumentacion justifikues të nevojshëm dhe të hartojë ndarje detyrash për çdo punonjës.

-Nga Administratori i shoqërisë, t'i kushtohet vëmendje e duhur investimeve dhe rikonstrukcioneve të rrjetit të ujit të pijshëm dhe të ujërave të ndotura, bazuar rregullores higjieno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

VII. Nga auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automatjet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.,u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Më datën 03.12.2013 është lidhur kontratë kredie (për lëshim letër garancie bankare), ndërmjet Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë përfaqësuar nga A. D. dhe V. Bank Sh.a përfaqësuar nga F.D. në cilësinë e drejtorit të Filialit Tirana 6, me objekt “Banka më anë të kësaj kontrate kredie për lëshimin e letër-garancie bankare i jep (akordon) kredimarrësit një kredi në shumën 1,070,000 euro, me vlefshmëri maksimale 72 mujore në favor të përfituesit/sipërmarrësit FMO shpk, në kuadër të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë dhe Shoqërisë FMO shpk të përfaqësuar nga A.M. & Shoqërisë I.T.S. shpk në datën 14.10.2013, është lidhur aktmarrëveshja për “Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS), me 72 këste me interesa të kalkuluar 4.5 % në vit, kohëzgjatja e kredisë 6 vite, numri i kësteve në vit 12, me datë fillimi të kredisë 01.01.2014, me shumë totale interesi 168,589 lekë.

Në kontratën e kredisë të lidhur datë 03.12.2013, pika 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” përcakton se: *“...Kredimarrësi i detyrohet bankës një komision total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta swift) prej 2.4% të shumës totale të llogaritur mbi garancinë bankare prej 1’070’000 euro.Komisioni për lëshimin e letër garancisë bankare do të paguhet në dy këste të barabarta gjashtëmujore.*

Në përputhje me kushtet e punës së bankës për të cilat kredimarrësi ka marrë dijeni të plotë dhe i ka pranuar ato pa asnjë rezervë, kredimarrësi pranon që komisioni për lëshimin e letër-garancisë bankare është në bazë vjetore dhe i llogaritur mbi shumën maksimale të garancisë bankare dhe do të paguhet rregullisht çdo vit deri në datën e fundit të vlefshmërisë së garancisë bankare”.

Komision në total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta sëift) prej 2.4% , duhet të ishte llogaritur sipas një plan amortizimi në momentin e lidhje së kontratës së kredisë (për lëshim letër garancie bankare). Pra për cdo vit Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a, Lushnjë duhet të paguente në favor të V. Bank, 2.4 % të vlerës së mbetur të shlyerjes së principialit të kredisë dhe jo 2.4 % të shumës totale në vlerën 1,070,00 euro, siç përcaktohet në pikën 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” të kontratës.

Referuar observacioneve (dokumenteve vërtetues) është lidhur kontratë shtesë me nr. 795 prot, datë 07.04.2017 ndërmjet Shoqërisë Ujësjellës Sh.a, Lushnjë përfaqësuar nga A. D. dhe V. Bank Sh.a dhe pika 14 ndryshoj nga 2.4 % u bë 1.2 %, mbi vlerën totale prej 1,070,000 euro dhe jo sipas planit të amortizimit pra për vlen e mbetur dhe mbi të gjitha që nga data e lidhjes së kësaj marrëveshje, pra data 07.04.2017, marrëveshje në favor të V. Bank, dhe në kushte të disfavorshme për ndërmjet Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, në kundërshtim me likuidimin në fakt, i cili deri më 31.12.2016 është bërë për vlerën e mbetur dhe jo për vlerën fillestare.

Në total këstet e kredisë që nga viti 2014 deri më 31.12.2016 janë në vlerën 75,308 euro, që kanë të bëjnë me komisionin e lëshimit të garancisë bankare në masën 2.4% nga V. Bank, ndërsa po të ishte likuiduar sipas marrëveshjes vlera duhet të ishte 77,04 euro.

Norma e interesit që do aplikohet sipas pikës 7 të kontratës së letër garancisë me bankën është caktuar 12% në vit, ndërsa në total kostoja e kredisë (NEI) 15.2% në vit.

Referuar analizës së ndërmjetësimit financiar tremujori i I-rë i vitit 2014, nga Banka e Shqipërisë (faqe 12) rezulton se: “Në rritjen e koston së ndërmjetësimit në euro ka ndikuar

edhe rritja e normës së interesit të kredisë. Kjo e fundit rezultoi mesatarisht 7.10%, duke u rritur me 0.16 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe 0.42 pikë përqindje kundrejt një viti më parë. Normat e larta të interesit të kredisë në euro reflektojnë vlerësimin e lartë për rrezikun e kredisë nga ana e bankave, dhe veçanërisht për kreditë për investime afatgjata të bizneseve. Spread-i i tyre kundrejt normave EURIBOR me maturitet 12-mujor është luhatur në nivelet 6.4-6.5 pikë përqindje gjatë 12 muajve të fundit” (pra nga 7.10% aktualisht – 0.16% rritje = 6.94% për tremujorin e fundit 2013)

Rreth 6.94% do të ishte interesi për kredi dhe jo 12% sa ç’është përcaktuar në kontratë.

Në qoftë se kjo garanci do të ekzekutohet, fakt që janë plotësuar të gjitha kushtet e marrëveshjes për tu ekzekutuar përbën një risk të lartë për UK Lushnjë, me efekt financiar në vlerën 192,691 euro (Llogaritja e interesit total sipas planit të amortizimit me normë interesi 12% në vit për afat 6 vjet shkon në 436,146 euro, ndërsa interesi total sipas planit të amortizimit me normë interesi 7% në vit për afat 6 vjet shkon në 243,455 euro. *Diferenca 5% interes në vit që del ndërmjet dy plan amortizimeve është 192,691 euro*).

Vlera 192,691 euro përbën dëm të mundshëm ekonomik për shoqërinë ‘Ujësjetllës kanalizime’ Sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Administrativ të shqyrtohet kontrata e kredisë e lidhur datë 03.12.2013, ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe V. Bank, si dhe të merret vendimi përkatës për zbatimin e saj konform legjislacionit përkatës.

Menjëherë

-Nga Administratori i Shoqërisë të rinegociohet me V. Bank për të saktësuar pikën 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” të kontratës së kredisë të lidhur datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe V. Bank, për sa i përket komisionit (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta sëift) prej 1.2%, komision i cili duhet të likuidohet në favor të V. Bank, sipas një plan amortizimi (1.2% të vlerës së mbetur të shlyerjes së principlialit të kredisë dhe jo 1.2 % të shumës totale prej 1,070,00 euro).

Brenda datës 30.06.2017

VIII. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk është organizuar dhe nuk funksionon njësia e auditit të brendshëm, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 345, datë 1.6.2004 “Për aprovimin e manualit të procedurave të Auditit të Brendshëm, mbi Kodin e Auditit të Brendshëm dhe mbi Auditimin e Brendshëm Publik”, seksioni II, pika 8 ku citohet “Shoqëritë anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind detyrohen të ngrenë strukturën e auditimit sipas kriterëve të përcaktuara me sipër, e cila i raporton këshillit mbikëqyrës. Të gjithë auditet e këtyre shoqërive emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Mbikëqyrës” *(Trajtuar më hollësisht në faqet 97-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Administrativ të merren masa që në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të jetë organizuar dhe të funksionojë Njësia Auditit të

Brendshëm, në zbatim të VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Për aprovimin e manualit të procedurave të Auditit të Brendshëm, mbi Kodin e Auditit të Brendshëm dhe mbi Auditimin e Brendshëm Publik”, seksioni II, pika 8.

Brenda datës 30.09.2017

2. Gjetje nga auditimi:

-Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, nuk është realizuar, kjo në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi edhe nga Ministria e linjës nuk është kërkuar që ky detyrim dhe në zbatim të ligjit të MFK, nga shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë të dërgohej pranë kësaj Ministrie “Pyetësori i vetëvlerësimit”.

Në Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk është implementuar asnjë procedurë në lidhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk janë caktuar sipas kërkesave të ligjit, as nëpunësi autorizues dhe as nëpunësi zbatues, veprimtaria menaxheriale ka funksionuar vetëm sipas rregullores së brendshme të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në datën 21.01.2008, dhe për rrjedhojë:

- Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar regjistrin ose raportin e përgjithshëm të risqeve.

- Nuk është realizuar deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

- Nuk është përcaktuar dhe miratuar strategjia, nuk janë përcaktuar objektivat strategjike për secilin funksion, politikat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, plani i zhvillimit, të cilat duhet të ishin të shoqëruara me plan-veprime dhe objektiva për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse.

- Për vitet 2015 dhe 2016 nuk ka urdhër të Administratorit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

- Rregullorja e shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk parashikon me hollësi dhe saktësi të gjitha detyrat dhe funksionet e stafit të shoqërisë sipas strukturës së miratuar.

- Nuk janë miratuar rregullore/udhëzime të brendshme në lidhje me etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxherëve, marrëdhëniet me të tretët, etj.

- Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe operacionet e njësive publike.

- Nuk ka politika për menaxhimin e burimeve njerëzore, pasi mungon një Rregullore, ku janë përcaktuar detyrat e sektorëve dhe linjat e raportimit. Nuk ka të miratuar përshkrime të detyrave individuale. Nuk ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga Administratori, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 97-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, si dhe të hartojë plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10,296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Brenda datës 30.06.2017

Në kuadrin e zbatueshmërisë të Ligjit nr. 10,296, datë 08.7.2010, të bëhen kualifikime e seminare për zbërthimin e ligjit, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur

më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e MFK për të gjithë menaxherët e shoqërisë, më qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

Vazhdimisht

-Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për hartimin e Udhëzuesit rregullativ, të shkruar lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 10,296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke përcaktuar strukturat menaxheriale, nëpunësin autorizues, nëpunësin zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse.

Brenda datës 30.06.2017

-Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për hartimin e rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, ku të implementohen sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm në zbatim të Ligjit nr. 10,296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 30.06.2017

IX. Nga auditimi mbi zbatimin e standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe të ujërave të ndotura, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

-Prodhimi dhe furnizimi i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, nuk është kryer plotësisht në zbatim të standardeve shtetërore. Konkretisht nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit të pijshëm, si dhe nuk janë kryer analizat të PH të ujit.

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka realizuar plotësisht mbrojtjen hijeno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, duke përcaktuar zonat e mbrojtura nr. 1, 2, 3, si dhe nuk janë pajisur me një leje nga autoriteti i basenit ujqor vendor, burimet që shfrytëzohen për qëllime të pirjes së ujit.

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e magjistraleve kryesore, dytësore dhe terciare të furnizimit me ujë të pijshëm, terciare të cilat duhet të ishin formatuar në rrjetin koordinativ shtetëror, ku të jenë përcaktuar koordinatat përkatëse. Veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 17.05.1984 “Për punimet topogjeodezike dhe hartografike”, pika 7, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 07.07.1984 “Për prodhimin, përdorimin dhe shitjen e hartave topografike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 12.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, përfituar nga fotografimi ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë”.

-Në këtë shoqëri, nuk ka rregullore (metodikë) të kryerjes nga laboratorit të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm.

-Në zbatim të VKM nr. 63, 27.01.2016 dhe Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015, prej datës 1 janar 2017 dhe në vazhdim shoqëria Uk Lushnjë mbulon me shërbimin e furnizimit të ujit dhe largimin e ujërave të ndotura, ish-sha Lushnjë si dhe komunat Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj. Nga auditimi u konstatua se për këtë periudhë nuk është kryer klorinimi i ujit të pijshëm.

Veprime në kundërshtim VKM Nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullore higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”, ndryshuar me VKM nr. 96, datë 22.02.2007, pika 2 “Kërkesa e cilësisë” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Uji i dhënë për konsum njerëzor duhet paraprakisht të dezinfektohet me përjashtim të ujit të ambalazhuar”, si dhe Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, që prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, të kryhet në zbatim të standardeve shtetërore të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullore “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve Sh.a” dhe VKM nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullore higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

Urgjent

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, për të realizuar plotësisht mbrojtjen higjeno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, në zbatim të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullore “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve Sh.a” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse”.

Urgjent

2. Gjetje nga auditimi:

-Në qytetin e Lushnjës, grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura nuk kryhet plotësisht në magjistralet kryesore, dytësore dhe terciare, por pasi grumbullohet nga shtëpitë, pallatet shumëkatëshe, institucionet dhe bizneset derdhet në kolektorin kryesor (kolektor i hapur) që përshkon qytetin duke filluar nga varrezat publike të qytetit, vazhdon në Komisariatit e Policisë, në shëtitoren kryesore, në shinat e trenit, mes përmes tokave bujqësore deri në kanalet e hapura, duke u derdhur në Detin Adriatik, me një gjatësi të konsiderueshme rreth 4 km brenda qytetit me një sipërfaqe rreth 2.5 km² ose 2,500,000 m², si dhe në kolektori që përshkon nga Spitali deri kanalin e Lushnjës (kolektor i hapur) një gjatësi rreth 3 km brenda qytetit, me një sipërfaqe rreth 4.7 km², ose 4,700,000 m², me sipërfaqe totale vetëm brenda qytetit të Lushnjës 7,200,000 m² ose 720 ha, kolektor me ujëra të ndotura, komerciale dhe industriale që përshkojnë Qytetin e Lushnjës.

Ujërat e ndotura të Qytetit Lushnjë, janë bashkuar me ujërat e shiut, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullore higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”, ndryshuar.

Të dy këto kolektorë, pasi përshkojnë qytetin derdhen në tokat bujqësore (ambient i hapur) duke kaluar në kanalet kulluese të tokës arë, e cila përdoret nga ekonomitë fshatare për kultivimin e bimëve të ndryshme bujqësore, psh sera për prodhim perimesh, grurë misër,

kultura foragjere për blegtorinë, pemë frutore, komplekse blegtorale etj, duke prishur të gjithë ekosistemin e zonës.

Në ujërat e ndotura familjare derdhen edhe ujërat e ndotura komerciale dhe industriale si: fabrika e qumështit, fabrika e konservimit të ushqimit, fabrika e vajit, fabrika e mermerit, pikat e servisit të makinave dhe bojërave, lavazhot e makinave, spitali i qytetit, ambulancat e qytetit, laboratorët e shëndetit, bujqësor etj, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale.

Të gjitha këto mbetje nuk derdhen në lëndfill apo incineratori apo çdo vend tjetër i përcaktuar me ligj, ku lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve, në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Për pos të sa trajtuar mësipër

Të dy kolektorët e qytetit bashkohen në një kolektor të vetëm, i cili kalon paralel në një distancë rreth 10 m, në vend depozitimin e mbetjeve urbane të Qytetit të Lushnjës (verifikuar nga Gjeoportali për informacionin Gjeohapsinor), me një sipërfaqe rreth 13,500 m², duke përshkruar pastaj të gjithë fushat bujqësore të Myzeqesë duke u derdhur në det.

Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë e ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

-Nga kjo shoqëri, nuk është dërguar asnjë informacion dhe asnjë kërkesë institucioneve kompetente, si dhe organeve drejtuese: si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura dhe ndikimet e tyre në mjedis, me problematikën e përshkruar mësipër, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Licenca nr. 8, datë 23.09.2016, protokolluar me nr. 86/5, datë 07.11.2016 në protokollin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha dhënë nga Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për kategorinë C “Për largimin e ujërave të ndotura”, është dhënë pa i kërkuar asnjë dokumentacion kësaj shoqërie si : magjistralet kryesore, dytësore dhe terciarë të ujërave të ndotura si dhe vend shkarkimi i tyre i autorizuar nga organi kompetent.

Si dhe

-Planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe kryerja e analizave të ujërave të ndotura, dhe zbatimin e standardeve shtetërore për këtë qëllim.

-Mbajtjen e ditarit të regjistrimit të të dhënave të prodhimit, grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Mbajtjen e regjistrit të ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale

dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

Në opinionin tonë: Për sa trajtuar më sipër veprimtaria e “Ujës-jellës Kanalizime sh.a” Lushnjë, është veprimtari që shkakton ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut dhe të kafshëve.

Për më tepër substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme që vijnë nga ujërat e ndotura komerciale dhe industriale, janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e **një aksidenti madhor** dhe duhet të nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”.

Theksojmë se vetëm për 5 vite (2012, 2013, 2014, 2015, 2016), UK Lushnjë ka faturuar nga familjarët, biznesi dhe institucionet publike sasinë **3,562,466 m³** ujë të ndotur **me vlerë 53,462,911 lekë** për grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotur, dhe jo vetëm që nuk e ka kryer këtë shërbim edhe pse është paguar nga qytetarët dhe biznesi, por në kundërshtim me dispozitat ligjore të përmendura në këtë procesverbal, ka ndotur ambientin deri në atë masë të ndotjes së ambientit brenda në Qytetin e Lushnjës dhe në të gjithë sipërfaqet e mbjella me bimë bujqësore, pemëtoje, mbashttrim të kafshëve etj të fshatrave përreth, në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis (ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët etj) duke vënë në rrezik shëndetin e njeriut, në rastin e një aksidenti madhor dhe duhet urgjentisht të nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin, kufizimin dhe eliminimin e kësaj ndotjeje.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10,431, datë 29.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujës-jellës-kanalizimeve Sh.a”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria “Ujës-jellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, për monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe të kryhen analizat e ujërave të ndotura, në zbatim të standarteve shtetërore të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujës-jellës-kanalizimeve Sh.a”, Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse”, Ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10,431, datë 29.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujës-jellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, për të mbajtur regjistrin shkrimor dhe elektronik të ujërat të ndotura, që nuk mund të shkarkohen në sistemin

publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtjen e tyre dhe largimin në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistrin e heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, duke zbatuar procedurat e përcaktuara sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se në qytetin e Lushnjë kryejnë aktivitetin e tyre 25 lavazho dhe në 13 prej tyre furnizimi me ujë kryhet nga magjistrali kryesor i furnizimit të qytetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm Kreu V, pika 2, 3 dhe 4; nuk janë të pajisura me leje ose autorizimi mjedisore nga Agjencia Rajonale e Mjedisit; nuk kanë kontrata për furnizimin me ujë me UK Lushnjë, si dhe nuk paguajnë asnjë detyrim për ujin e përdorur; nuk janë të pajisura me leje e ushtrimit të aktivitetit nga Bashkia.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 28.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 (i ndryshuar) “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve Sh.a”, Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003”Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr. 111/2012 “Menaxhimi i burimeve ujore, Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë verifikimin e subjekteve që kryejnë aktivitetin e lavazhove (subjekte të përmendura në raportin përfundimtar), dhe të përcaktojë burimin e furnizimit me ujë dhe pajtueshmërinë e këtij furnizimi konform dispozitave ligjore për këtë qëllim, si dhe të kryejë ekzaminimet teknike për ndotjen ose jo të ambientit

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se lavazhot e kryejnë aktivitetin e tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore të përmendur më sipër, të zbatohen procedurat ligjore për ndërprerjen e aktivitetit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

-Humbjet e shoqërisë nuk do të ishin thelluar në atë masë, nëse ekspertët kontabël do të kishin kryer misionin e tyre me pavarësi dhe besnikëri ndaj ligjit. Ekspertët i kanë vlerësuar sipërfaqësisht pasqyrat financiare, dhe nuk kanë bërë analizë të plotë të instrumenteve të përdorur për të zvogëluar (fshehur) humbjen financiare dhe për të mos bërë transparencën e gjendjes financiare të shoqërisë, por vetëm me paratë e marra nga kjo shoqëri, kanë krijuar imazhin e certifikimit të pavarur të llogarive të shoqërisë.

Për pos sa më sipër

Në opinionin e dhënë nga audituesit e pasqyrave financiare, në raportet auditimit dhe/apo letrat e rekomandimit për drejtimin, konstatohet se audituesit e pasqyrave financiare ndër vite, kanë kryer auditimin e tyre në zbatim të SNA 200 “Objektivat e përgjithshëm të Audituesit të Pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, por nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me SNA 250 “Mbajtja Parasyshe e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se nga auditimi i kryer nga KLSH për vitet ushtrimore 2016 dhe 2017, janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese; hartimin dhe realizimin e programit ekonomik; plotësimin e pasqyrave financiare (bilancit); pagesat e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës; prokurimin e fondeve dhe zbatimin e kontratave të punimeve; organizimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; zbatimin e standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura; regjistrimin e aseteve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit ekonomik; marrëdhëniet e punës; zbatimin e ligjit për konfliktin e interesave. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), për pasojë **vlera 396,000 lekë** është përfituar padrejtësisht nga ekspertët kontabël.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 4 dhe 9, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10,091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimi i profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar si kontabilist i miratuar”, Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Qendra kombëtare e regjistrimit”, çka ngarkon me përgjegjësi E. Dh. dhe B. B. me detyrë eksperte kontabël.

Vlera 396,000 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lushnjë dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. Dh. dhe B. B. , të cilët me veprimet e mos veprimet e tyre kanë dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “UK Lushnjë ” Sh.a si dhe të shtetit në vlerën 396,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 396,000 lekë** nga E. Dh. dhe B. B. në cilësinë ekspertëve kontabël. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), “Mbajtja Parasyshe e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, pasi në raportet e auditimit të ekspertëve, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë pasqyrat financiare, si dhe humbjet e shoqërisë nuk do të ishin thelluar në atë masë, nëse ekspertët kontabël do të kishin kryer misionin e tyre me pavarësi dhe besnikëri ndaj ligjit. Ekspertët i kanë vlerësuar sipërfaqësisht pasqyrat financiare, dhe nuk kanë bërë analizë të plotë të instrumenteve të përdorur për të zvogëluar (fshehur) humbjen financiare dhe për të mos bërë transparencën e gjendjes financiare të shoqërisë, por vetëm me paratë e marra nga kjo shoqëri, kanë krijuar imazhin e certifikimit të pavarur të llogarive të shoqërisë.

Brenda datës 30.09.2017

2. Gjetje nga auditimi:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shitjes dhe Departamenti i Projekteve dhe Supervizionit u konstatua se në 50 pallate shumëkatëshe vetëm për 32 prej tyre janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimet financiare, ndërsa në 18 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën 540,000 lekë (18 pallate x 30,000 lekë tarifa për pikën e lidhjes).

Për pos sa mësipërm, në këto pallate janë 2,582 apartamente gjithsej, nga të cilat 1,199 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 1,045 apartamente janë pa shitur, në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, 64 apartamente janë të pa shitur por të paguara nga investitorët, ndërsa 274 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8,000 lekë për kontratën. Totali 1319 apartamente x 8000 lekë/kontratë uji = 10,552,000 lekë..

Duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën është në vlerën 10,552,000 lekë

Dëmi ekonomik gjithsej për shoqërinë UK Lushnjë dhe Buxhetin të Shtetit është në vlerën 11,092,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 11,092,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos pagimin e pikave të lidhjes për 18 pallatet të reja shumë katëshe dhe për mos lidhjen e kontratave të ujit të pijshëm për 1139 apartamente. *Në mënyrë të detajuar aneksi nr. 1, pjesë e këtij Raport Përfundimtar Auditimi.*

Brenda datës 30.09.2017

3. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime SH.A Lushnjë për kryerjen e funksioneve të saj, ka në përdorim dy programe kompjuterike, “Alpha Water Bill” dhe “Alpha Buxhetor”. Programi i parë shërben për hedhjen e faturimeve në mënyrë manuale, si dhe hedhjen e pagesave të abonentëve nga punonjësit e arkës. Ndërsa programi i dytë, shërben për mbajtjen e llogarive nga ana e sektorit të financës. Këto dy programe nuk ndërlidhen automatikisht dhe nuk shkëmbejnë të dhëna automatikisht apo online nga një program në tjetrin. Të dhënat, pasi merren nga departamenti i shitjes nga program i parë, hidhen manualisht nga financa në programin e dytë.

Programi “Alpha Water Bill” është implementuar në datën 26.06.2006, nga ana e kompanisë I.M.B.. Gjithashtu çdo vit nënshkruhet një kontratë një vjeçare mirëmbajtjeje ndërmjet UKSHAL dhe I.M.B.. Ky shërbim ka filluar në datën 16.03.2009 dhe aktualisht përfundon në datën 25.04.2017. Nga testet e kryera për programin “Alpha Water Bill” u konstatua se ky program lejon modifikimin e të dhënave të hedhura, duke mos dhënë siguri të arsyeshme për mbarëvajtjen e të dhënave. Duhet theksuar se gjendja debitore e sistemeve është e ndryshme, gjë që shton problematikën e ngritur për pasigurinë e sistemit.

Një problem tjetër i konstatuar është se PC të ndryshme nxjerrin listë debitorësh të ndryshme dhe të pasaktë, pasi kanë filluar të hidhen të dhëna në fillim të muajit. Sipas stafit, mund të nxirret evidencë e saktë dhe e njëjtë nga PC të ndryshme, në rastin kur akoma janë pa hedhur leximet apo çdo veprim tjetër i muajit aktual. Mosfunksionimi i duhur për nxjerrjen e kësaj evidence duhet të ishte rregulluar nga kompania I.M.B., e cila ka kontratë mirëmbajtjeje, për të cilën merr paradhënie në fillim të çdo kontrate vjetore. Për sa më sipër, I.M.B. nuk i ka përmbushur detyrimet e kontratës së shërbimit. Gjithashtu nuk ka asnjë raport të kryerjes të ndonjë shërbimi nga ana e I.M.B.. Nga ana e drejtuesve të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SH.A Lushnjë, nuk është kryer asnjë veprim në mbrojtje të interesave financiare të shoqërisë, pasi për shërbimin në fjalë, deri në momentin e auditimit, janë paguar 1,430,217.2 lekë, të cilat janë të pajustificuara, pasi sistemi aktualisht, siç u përmend dhe më lartë, ka probleme në nxjerrjen e evidencave, të cilat janë të domosdoshme për verifikimin e situatës ekonomike të shoqërisë në një moment të caktuar. Për pasojë vlera 1,430,217 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 115-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 1,430,217 lekë** nga I.M.B., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratave vjetore të shërbimit për vitet 2009-2016.

Brenda datës 30.09.2017

4. Gjetje nga auditimi:

Për vitet 2015 dhe 2016, si rezultat i zgjidhjes të kontratës së punësimit (largimet nga puna), pa shkaqe të arsyeshme është penalizuar Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë nga vendimet e gjykatave në 1 rast në vlerën **351,009 lekë**, vlerë e cila për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Administrativ të shqyrtohet vlera 351,009 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me zgjidhjen në një rast të kontratës së punësimit (largimet nga puna), pa shkaqe të arsyeshme, duke penalizuar Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë nga vendimet e gjykatave në vlerën **351,009 lekë**, vlerë e cila për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës për dëmshpërblim.

Brenda datës 30.09.2017

5. Gjetje nga auditimi:

-Nuk është zbatuar aktmarrëveshja e datës 27.02.2015 e lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe Shoqërive FMO shpk, I.T.S. shpk dhe Shoqërisë

UK Lushnjë, pasi nuk janë instaluar 500 matës elektronik wireless, si dhe 500 saraçineska $\frac{3}{4}$ (20 mm) dhe kundralvula 500 copë, por janë lënë në ruajtje.

Lënia në ruajtje përbën mos zbatim të marrëveshjes, e cila është kryer në tejkallim të kompetencës nga administratori i shoqërisë A. D., veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statutin e shoqërisë, si dhe rregulloren e brendshme, pasi kjo marrëveshje është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 14.09.2013 dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve nr. 4, datë 25.09.2013, marrëveshje e cila përcakton instalimin e 6,000 matësve. Mos zbatimi i kësaj mosmarrëveshje ka krijuar një dëm ekonomik për shoqërinë UK Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën në vlerën 60,000 euro (*Trajtuar më hollësisht në faqet 81-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Administrativ të shqyrtojë vlerën **60,000 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e aktmarrëveshjes së lidhur në datën 14.10.2013 ndërmjet Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Lushnjë Sh.a. dhe Shoqërisë FMO shpk , për arsye se nuk janë instaluar 500 matës elektronik wireless, 500 saraçineska $\frac{3}{4}$ (20 mm) dhe kundralvula 500 copë, por janë lënë në ruajtje. Lënia në ruajtje është kryer në tejkallim të kompetencës nga Administratori i shoqërisë A. D., veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statutin e shoqërisë, si dhe rregulloren e brendshme, pasi kjo marrëveshje është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 14.09.2013 dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4, datë 25.09.2013, marrëveshje e cila përcakton instalimin e 6,000 matësve. Vlera 60,000 euro për Shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës për dëmshpërblim.

Brenda datës 30.06.2017

5. Gjetje nga auditimi:

Ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Sha, Lushnjë dhe V. Bank Sh.a në datën 03.12.2013 është lidhur kontratë kredie (për lëshim letër garancie bankare) në vlerën 1,070,000 euro, në kuadër të kontratës së lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe shoqërive FMO shpk & I.T.S. shpk në datën 14.10.2013, “Për financimin dhe instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS). Në kontratë përcaktohen 72 këste me interesa të llogaritur 4.5 % në vit, kohëzgjatja e kredisë 6 vite, numri i kësteve në vit 12, me datë fillimi të kredisë 01.01.2014, me shumë totale interesi 168,589 euro.

Norma e interesit që do aplikohet sipas pikës 7 të kontratës së letër garancisë me bankën është caktuar 12% në vit, ndërsa në total kostoja e kredisë (NEI) 15.2% në vit.

Referuar analizës së ndërmjetësimit financiar tremujori i I-rë i vitit 2014, nga Banka e Shqipërisë (faqe 12) rezulton se: “Në rritjen e kostos së ndërmjetësimit në euro ka ndikuar edhe rritja e normës së interesit të kredisë. Kjo e fundit rezultoi mesatarisht 7.10%, duke u rritur me 0.16 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe 0.42 pikë përqindje kundrejt një viti më parë. Normat e larta të interesit të kredisë në euro reflektojnë vlerësimin e lartë për rrezikun e kredisë nga ana e bankave, dhe veçanërisht për kreditë për investime afatgjata të bizneseve. Spread-i i tyre kundrejt normave EURIBOR me maturitet 12-mujor është luhatur në nivelet 6.4-6.5 pikë përqindje gjatë 12 muajve të fundit (pra nga 7.10% aktualisht – 0.16% rritje = 6.94% për tremujorin e fundit 2013) 6.94% do të ishte interesi për kredi dhe jo 12% sa ç’është përcaktuar në kontratë.

Në qoftë se kjo garanci do të ekzekutohet, fakt që janë plotësuar të gjitha kushtet e marrëveshjes për tu ekzekutuar përbënë një risk të lartë për UK Lushnjë, me efekt financiar në vlerën 192,691 euro (Llogaritja e interesit total sipas planit të amortizimit me normë interesi 12% në vit për afat 6 vjet shkon në 436,146 euro, ndërsa interesi total sipas planit të amortizimit me normë interesi 7% në vit për afat 6 vjet shkon në 243,455 euro. *Diferenca 5% interes në vit që del ndërmjet dy plan amortizimeve është 192,691 euro*).

Vlera 192,691 euro përbën dëm të mundshëm ekonomik për shoqërinë ‘Ujësjetllës kanalizime’ Sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit.

Për lidhjen e kësaj kontrate për lëshimin e letër garancisë, Administratori i Shoqërisë UKL Lushnjë, ka negociuar me V. Bank për normën e interesit, pa testuar tregu financiar (12 bankat e tjera që operon kjo shoqëri) apo Bankën e Shqipërisë për normën mesatare të interesit të kredisë, por ka pranuar apriori normën 12% në vit të vënë nga V. Bank, rreth 5% interes në vit më shumë se tregu bankar.

Në marrëveshjen e nënshkruar nga palët të datës 14.10.2013 “Për financimin dhe instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS“, nuk është përcaktuar që garancia bankare do të lëshohet nga V. Bank, kjo përzgjedhje është bërë në tejkallim të kompetencës nga administratori i shoqërisë dhe pa procedurë për testimin e tregut, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 13.

Në pikën 8.6 është përcaktuar se “*Pagesa e interesit të situacioneve do të fillojnë menjëherë pasi situacioni mujor/protokolli pranimit të jetë lëshuar dhe pranuar. Pagesa do të kryhet sipas tabelës së amortizimit siç është detajuar në aneksin nr. 3*”, çka do të thotë që interesat do të paguhën sipas aneksit nr. 3, bashkëlidhur marrëveshjes dhe jo sipas situacioneve respektive për punën e kryer.

Në fakt likuidimi është bërë sipas aneksit nr. 3, aneks që nuk i është vënë dispozicion në origjinal grupit të auditimit, por është vënë në dispozicion dokument ekzemplar, i fotokopjuar i sigluar me vulën e shoqërisë FMO, në fakt dokumenti i fotokopjuar përmban siglën (vulën) e Shoqërisë I.T.S. dhe vulën e V. Bank, pra është një dokument aspak i besueshëm.

Referuar Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, kontrata e kredisë (për lëshim letër garancie bankare) e lidhur më datën 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Sha Lushnjë përfaqësuar nga A. D. dhe V. Bank Sh.a përfaqësuar nga F. D. në cilësinë e drejtorit të filialit Tirana 6, me objekt “Banka me anë të kësaj kontrate kredie për lëshimin e letër-garancie bankare i jep (akordon) kredimarrësit një kredi në shumën 1,070,000 euro, është një akt absolutisht i pavlefshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Administrativ të shqyrtojë vlerën **192,691 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me lidhjen e kontratës së kredisë (për lëshim letër garancie bankare) datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sha, Lushnjë dhe V. Bank Sh.a në vlerën 1,070,000 euro, në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë tregun financiar, në disfavor të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a, Lushnjë me vlerë **192,691 euro**, si dhe në tejkallim të kompetencës nga administratori i shoqërisë A. D., veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statutin e shoqërisë, si dhe rregulloren e brendshme, pasi kjo marrëveshje nuk është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vlerë e cila

për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës për dëmshpërblim.

Brenda datës 30.06.2017

6. Gjetje nga auditimi:

Në ndërtimin e linjës KUZ Rruga Vasil Bello me gjatësi 260 ml me tub Ø 300 mm, u konstatua se në situacionin e këtij punimi nuk është vendosur asnjë tubacion sipas parashikimit dhe likuidimit dhe sasia prej 200 litra karburant e përdorur me këtë destinacion është e pajustificuar, në total vlera **228,600 lekë**. Me fletë daljen nr. 522 datë 13.10.2012 nga magazina, kanë dalë materialet ndërtimore si rërë lumi, tulla, rërë e larë, çimento, kapakë gize dhe stabilizant. Fletë hyrja në magazinë e tubit Ø 300 mm, me gjatësi 260 ml, nuk ekziston dhe rrjedhimisht nuk ka dalë prej saj. Në dokumentacion për këtë shpenzim nuk disponohet asnjë dokumentacion teknik si: Plan vendosja e objektit, gjendja ekzistuese, kërkesa për zëvendësim të tubacionit, dokumentacion fotografik, procesverbale të ndryshme të punës, libreza masash etj.

Për rrjedhojë e gjithë praktika e këtij shpenzimi nuk është e saktë dhe nuk justifikohet likuidimi.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe KTZ. Vlera prej 228,600 lekë, përbën dëm ekonomik për UK Lushnjë dhe buxhetin e shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 81-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Administrativ të shqyrtojë **vlerën 228,600 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara ndërtimin e Linjës KUZ rrugës Vasil Bello. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Shoqërinë “Ujësjellës kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.06.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, statutit të shoqërisë neni 30 (Për Administratorin), kontratës kolektive të punës neni 14, si dhe kontratave individuale të punës, neni 7, i kërkojmë Asamblesë së Përgjithshme dhe Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tyre ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

C/I. “Zgjidhje të kontratës së punësimit”

1. A. D., me detyrë Administrator për periudhën 23.08.2011 dhe në vazhdim.

Për arsye se:

-Nuk i ka trajtuar me korrektesë rekomandimet e KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2016 Konkretisht:

Nga 36 masa organizative të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 2, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 20 dhe nuk janë zbatuar 12. Nga 12 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara gjithsej, është zbatuar 1, është zbatuar pjesërisht 1, është në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 9.

Nga KLSH është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1119/108, datë 20.01.2017 dhe përsëri deri më datën 10.03.2017, datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk ka filluar zbatimi i masave të rekomanduara. Konkretisht është rikërkuar zbatimi i 11 masave organizative dhe 9 masave për shpërbllim dëmi në vlerën 61,878,282 lekë. Në mënyrë të detajuar masat e rekomanduara janë pasqyruar në shkresën përcjellëse nr. 1119/108, datë 20.01.2017, protokolluar në UK Lushnjë me nr. 151/3 prot, datë 24.01.2017.

Mos zbatimi i rekomandimeve është në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, çka ngarkon me përgjegjësi A. D. me detyrë administrator të shoqërisë, i cili me veprimet dhe mosveprimet e Tij, ka realizuar mospërbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë” dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 61,878,282 lekë, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Më datën 03.12.2013 ka lidhur kontratë kredie (për lëshim letër garancie bankare), në emër të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë me V. Bank Sh.a për vlerën 1,070,000 euro, me vlefshmëri maksimale 72 mujore në favor të përfituesit/sipërmarrësit FMO shpk, në kuadër të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë dhe Shoqërive FMO & Shoqërisë I.T.S. shpk në datën 14.10.2013.

Në kontratën e kredisë të lidhur datë 03.12.2013, pika 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” përcakton se: “...*Kredimarrësi i detyrohet bankës një komision total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta swift) prej 2.4% të shumës totale të llogaritur mbi garancinë bankare prej 1’070’000 euro.Komisioni për lëshimin e letër garancisë bankare do të paguhet në dy këste të barabarta gjashtëmujore.*

Në përputhje me kushtet e punës së bankës për të cilat kredimarrësi ka marrë dëjnen të plotë dhe i ka pranuar ato pa asnjë rezervë, kredimarrësi pranon që komisioni për lëshimin e letër-garancisë bankare është në bazë vjetore dhe i llogaritur mbi shumën maksimale të garancisë bankare dhe do të paguhet rregullisht çdo vit deri në datën e fundit të vlefshmërisë së garancisë bankare”.

Komision në total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta sëift) prej 2.4% , duhet të ishte llogaritur sipas një plan amortizimi në momentin e lidhjes së kontratës së kredisë (për lëshim letër garancie bankare). Pra për çdo vit Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a, Lushnjë duhet të paguente në favor të V. Bank, 2.4 % të vlerës së mbetur të shlyerjes së principialit të kredisë dhe jo 2.4 % të shumës totale në vlerën 1,070,00 euro, siç përcaktohet në pikën 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” të kontratës.

Referuar observacioneve (dokumenteve vërtetues) është lidhur kontratë shtesë me nr. 795 prot, datë 07.04.2017 ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Sh.a, Lushnjë përfaqësuar nga A. D. dhe V. Bank Sh.a dhe pika 14 ndryshoj nga 2.4 % u bë 1.2 %, mbi vlerën totale prej 1,070,000 euro dhe jo sipas planit të amortizimit pra për vlen e mbetur dhe mbi të gjitha që nga data e lidhjes së kësaj marrëveshje, pra data 07.04.2017, marrëveshje në favor të V. Bank, dhe në kushte të disfavorshme për ndërmjet Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, në kundërshtim me likuidimin në fakt, i cili deri më 31.12.2016 është bërë për vlerën e mbetur dhe jo për vlerën fillestare.

Në total këstet e kredisë që nga viti 2014 deri më 31.12.2016 janë në vlerën 75,308 euro, që kanë të bëjnë me komisionin e lëshimit të garancisë bankare në masën 2.4% nga V. Bank, ndërsa po të ishte likuiduar sipas marrëveshjes vlera duhet të ishte 77,04 euro.

Norma e interesit që do aplikohet sipas pikës 7 të kontratës së letër garancisë me bankën është caktuar 12% në vit, ndërsa në total kostoja e kredisë (NEI) 15.2% në vit.

Referuar analizës së ndërmjetësimit financiar tremujori i I-rë i vitit 2014, nga Banka e Shqipërisë (faqe 12) rezulton se: “Në rritjen e kostos së ndërmjetësimit në euro ka ndikuar edhe rritja e normës së interesit të kredisë. Kjo e fundit rezultoi mesatarisht 7.10%, duke u rritur me 0.16 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe 0.42 pikë përqindje kundrejt një viti më parë. Normat e larta të interesit të kredisë në euro reflektojnë vlerësimin e lartë për rrezikun e kredisë nga ana e bankave, dhe veçanërisht për kreditë për investime afatgjata të bizneseve. Spread-i i tyre kundrejt normave EURIBOR me maturitet 12-mujor është luhatur në nivelet 6.4-6.5 pikë përqindje gjatë 12 muajve të fundit” (pra nga 7.10% aktualisht – 0.16% rritje = 6.94% për tremujorin e fundit 2013)

Rreth 6.94% do të ishte interesi për kredi dhe jo 12% sa ç’është përcaktuar në kontratë.

Në qoftë se kjo garanci do të ekzekutohet, fakt që janë plotësuar të gjitha kushtet e marrëveshjes për tu ekzekutuar përbën një risk të lartë për UK Lushnjë, me efekt financiar në vlerën 192,691 euro (Llogaritja e interesit total sipas planit të amortizimit me normë interesi 12% në vit për afat 6 vjet shkon në 436,146 euro, ndërsa interesi total sipas planit të amortizimit me normë interesi 7% në vit për afat 6 vjet shkon në 243,455 euro. *Diferenca 5% interes në vit që del ndërmjet dy plan amortizimeve është 192,691 euro*).

Vlera 192,691 euro përbën dëm të mundshëm ekonomik për shoqërinë ‘Ujësjiellës kanalizime’ Sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit.

Veprimet e mësipërme janë kryer nga administratori A. D., pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (këshilli mbikëqyrës dhe asambleja e aksionareve), në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 13 “Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij **e veprimi nuk autorizohet**, paraprakisht, prej: ç) *këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e anëtarëve të këshillit të administrimit*” ose këshillit mbikëqyrës në shoqëritë aksionare, si dhe *statutin e shoqërisë*.

A. D. me veprimet dhe mos veprimet e tij në zbatim të kompetencave që i jep ligji, ka kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjën e interesave ligjshme të Uk Lushnjë, dhe të Shtetit në vlerën 192,691 euro, si dhe është cënuar autoriteti i Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Vendosjes të normave të amortizimit menaxheriale, shumë të vogla prej Tij, pa miratim të këshillit mbikëqyrës dhe të asamblesë së aksionarëve për të ulur humbjen, pra pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (këshilli mbikëqyrës dhe asambleja e aksionareve), me një efekt financiar **në vlerën 220,827 mijë lekë**.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 158, pika 3,c dhe ç, 4, 5, neni 16, pika 1,a, neni 167 “Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, neni 9, pika 1, neni 5, “Mbajtja e kontabilitetit”, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Për mos llogaritjen e kamatë vonesave për mos likuidimin e faturave të ujit (si për ato që nuk janë likuiduar asnjë herë, të likuiduar pjesërisht, ose që nuk janë likuiduar në kohën e duhur). Konkretisht gjendja debitore nga mos arkëtimi i faturave të ujit të pijshëm më datën 31.12.2016 paraqitet në vlerën 236,650,348 lekë. Kjo gjendje debitore nuk ka përfshirë

llogaritjen e kamatë vonesave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve”, Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si Titull Ekzekutiv”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7928, date 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar duke shkaktuar **te ardhura te munguara për shoqërinë në vlerën 23,650,348 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për mos zbatim të shkronjës “b” të nenit 1 të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, derdhur në Institutin e Integritetit të ish-të përndjekurve politikë, për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritetit të ish-të përndjekurve politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2015-2016 **në vlerën 1,221,776 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Në 50 pallate shumëkatëshe vetëm për 32 prej tyre janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimet financiare, ndërsa në 18 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën 540,000 lekë (18 pallate x 30,000 lekë tarifa për pikën e lidhjes).

Për pos sa mësipërm, në këto pallate janë 2,582 apartamente gjithsej, nga të cilat 1,199 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 1,045 apartamente janë pa shitur, në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, 64 apartamente janë të pa shitur por të paguara nga investitorët, ndërsa 274 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8,000 lekë për kontratën. Totali 1139 apartamente x 8000 lekë/kontratë uji = 10,552,000 lekë..

Duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën është në vlerën 10,552,000 lekë

Dëmi ekonomik gjithsej për shoqërinë UK Lushnjë dhe Buxhetin të Shtetit është në vlerën 11,092,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Me aktmarrëveshjen e lidhur në datën 27.02.2015 ndërmjet shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe shoqërive FMO dhe I.T.S. shpk, është shtyrë afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar datë 14.10.2013, ku

citohet në nenin 2, *se palët bien dakord që afati i përfundimit të punimeve të shtyhet deri në një kohët të dytë e varur kjo nga momenti, kur do të bëhet e mundur sigurimi i marrëveshjes ndërmjet PI dhe OSHEE, për furnizimin me energji elektrike të pajisjeve pjesë e rrjetit të komunikimit të matësve.*

Në aktmarrëveshjen bazë nuk ka asnjë modalitet të përcaktuar për furnizimin ose jo me energji elektrike nga OSHEE, për pasojë kjo shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve të përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar në datën 14.10.2013, është kryer në shkelje të kompetencave ligjore nga administratori i shoqërisë, për pasojë aktmarrëveshja e lidhur 27.02.2015 ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe shoqërisë FMO shpk të përfaqësuar nga A.M. shoqërisë I.T.S. shpk nga K.Z., **është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi:**

-Nuk ka vendim të këshillit mbikëqyrës dhe të asamblesë **që të shtyhet ky afat**, theksojmë se aktmarrëveshja e datës 14.10.2013 e lidhur ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë dhe shoqërive FMO & I.T.S. shpk është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 14.09 dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4, datë 25.09.2013.

Zgjatja e afatit nga A. D. pa delegim kompetence është në kundërshtim Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, *shtuar edhe faktit që kjo marrëveshje, është e firmosur dhe nga shoqëria I.T.S. shpk e përfaqësuar nga K.Z., i cili me deklaratën noteriale me nr. 335 repertori, nr. 194 koleksioni, datë 24.01.2014, nuk do të jetë me pjesë e kësaj aktmarrëveshje. Konkretisht me Deklaratën noteriale me nr. 335 repertori, nr. 194 koleksioni, datë 24.01.2014 e firmosur nga FMO dhe I.T.S. ndër të tjera citon se “..... ku do të saktësohet dhe cilësohet që I.T.S. shpk nuk do të jetë më pjesë dhe nuk do të ketë më asnjë detyrim kontraktual për kontratën në fjalë”.*

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statutin e shoqërisë, neni 13 “Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit të tij ose veprimi nuk autorizohet, paraprakisht, prej: ç) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e anëtarëve të këshillit të administrimit” (Trajtuar më hollësisht në faqet 81-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

-Prodhimi dhe furnizimi i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, nuk është kryer plotësisht në zbatim të st

andarëve shtetërore. Konkretisht nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit të pijshëm, si dhe nuk janë kryer analizat të PH të ujit.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka realizuar plotësisht mbrojtjen hijeno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, duke përcaktuar zonat e mbrojtura nr. 1, 2, 3, si dhe nuk janë pajisur me një leje nga autoriteti i basenit uJOR vendor, burimet që shfrytëzohen për qëllime të pirjes së ujit.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e magjistrave kryesore, dytësore dhe terciare terciare të furnizimit me ujë të pijshëm, terciare të cilat duhet të ishin formatuar në rrjetin koordinativ shtetëror, ku të jenë përcaktuar koordinatat përkatëse. Veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 17.05.1984 “Për punimet topogjeodezike dhe hartografike”, pika 7, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 07.07.1984 “Për prodhimin, përdorimin dhe shitjen e hartave topografike”,

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 12.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, përfituar nga fotografimi ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë”.

-Në këtë shoqëri, nuk ka rregullore (metodikë) të kryerjes nga laboratorit të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm.

-Në zbatim të VKM nr. 63, 27.01.2016 dhe Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015, prej datës 1 janar 2017 dhe në vazhdim shoqëria Uk Lushnjë mbulon me shërbimin e furnizimit të ujit dhe largimin e ujërave të ndotura, ish-sha Lushnjë si dhe komunat Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj. Nga auditimi u konstatua se për këtë periudhë nuk është kryer klorinimi i ujit të pijshëm.

Veprime në kundërshtim VKM Nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”, ndryshuar me VKM nr. 96, datë 22.02.2007, pika 2 “Kërkesa e cilësisë” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Uji i dhënë për konsum njerëzor duhet paraprkasht të dezinfektohet me përjashtim të ujit të ambalazhuar”, si dhe Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në Qytetin e Lushnjës, grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura nuk kryhet plotësisht në magjistralet kryesore, dytësore dhe terciare, por pasi grumbullohet nga shtëpitë, pallatet shumëkatëshe, institucionet dhe bizneset derdhet në kolektorin kryesor (kolektor i hapur) që përshkon qytetin duke filluar nga varrezat publike të qytetit, vazhdon në Komisariatin e Policisë, në shëtitoren kryesore, në shinat e trenit, mes përmes tokave bujqësore deri në kanalet e hapura, duke u derdhur në Detin Adriatik, me një gjatësi të konsiderueshme rreth 4 km brenda qytetit me një sipërfaqe rreth 2.5 km² ose 2,500,000 m², si dhe në kolektorin që përshkon nga Spitali deri kanalën e Lushnjës (kolektor i hapur) një gjatësi rreth 3 km brenda qytetit, me një sipërfaqe rreth 4.7 km², ose 4,700,000 m², me sipërfaqe totale vetëm brenda qytetit të Lushnjës 7,200,000 m² ose 720 ha, kolektor me ujëra të ndotura, komerciale dhe industriale që përshkojnë Qytetin e Lushnjës.

Ujërat e ndotura të Qytetit Lushnjë, janë bashkuar me ujërat e shiut, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”, ndryshuar.

Të dy këto kolektorë, pasi përshkojnë qytetin derdhen në tokat bujqësore (ambient i hapur) duke kaluar në kanalet kulluese të tokës arë, e cila përdoret nga ekonomitë fshatare për kultivimin e bimëve të ndryshme bujqësore, psh sera për prodhim perimesh, grurë misër, kultura foragjere për blegtorinë, pemë frutore, komplekse blegtorale etj, duke prishur të gjithë ekosistemin e zonës.

Në ujërat e ndotura familjare derdhen edhe ujërat e ndotura komerciale dhe industriale si: fabrika e qumështit, fabrika e konservimit të ushqimit, fabrika e vajit, fabrika e mermerit, pikat e servisit të makinave dhe bojërave, lavazhot e makinave, spitali i qytetit, ambulancat e qytetit, laboratorët e shëndetit, bujqësor etj, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale.

Të gjitha këto mbetje nuk derdhen në lëndfill apo incineratori apo çdo vend tjetër i përcaktuar me ligj, ku lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve, në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Për pos të sa trajtuar mësipër

Të dy kolektorët e qytetit bashkohen në një kolektor të vetëm, i cili kalon paralel në një distancë rreth 10 m, në vend depozitimit e mbetjeve urbane të Qytetit të Lushnjës (verifikuar nga Gjeoportali për informacionin Gjeohapsinor), me një sipërfaqe rreth 13,500 m², duke përshkruar pastaj të gjithë fushat bujqësore të Myzeqesë duke u derdhur në det.

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë e ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

-Nga kjo shoqëri, nuk është dërguar asnjë informacion dhe asnjë kërkesë institucioneve kompetente, si dhe organeve drejtuese: si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura dhe ndikimet e tyre në mjedis, me problematikën e përshkruar mësipër, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Në opinionin tonë: Për sa trajtuar mësipër veprimtaria e “Ujësjiellës Kanalizime sha” Lushnjë, është veprimtari që shkakton ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut dhe të kafshëve.

Për më tepër substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme që vijnë nga ujërat e ndotura komerciale dhe industriale, janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e **një aksidenti madhor** dhe duhet ti nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”.

Theksojmë se vetëm për 5 vite (2012, 2013, 2014, 2015, 2016), UK Lushnjë ka faturuar nga familjarët, biznesi dhe institucionet publike sasinë **3,562,466 m³** ujë të ndotur **me vlerë 53,462,911 lekë** për grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotur, dhe jo vetëm që nuk e ka kryer këtë shërbim edhe pse është paguar nga qytetarët dhe biznesi, por në kundërshtim me dispozitat ligjore të përmendura në këtë procesverbal, ka ndotur ambientin deri në atë masë të ndotjes së ambientit brenda në Qytetin e Lushnjës dhe në të gjithë sipërfaqet e mbjella me bimë bujqësore, pemëtoje, mbashtrim të kafshëve etj të fshatrave përreth, në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis (ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët etj) duke vënë në rrezik shëndetin e njeriut, në rastin e një aksidenti madhor dhe duhet urgjentisht ti nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin, kufizimin dhe eliminimin e kësaj ndotjeje.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10,431, datë 29.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës-kanalizimeve Sh.a”, Vendimin e Këshillit të

Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Për vitet 2015 dhe 2016, si rezultat i zgjidhjes të kontratës së punësimit (largimet nga puna), pa shkaqe të arsyeshme Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, është penalizuar nga vendimet e gjykatave në 1 rast në vlerën 351,009 lekë, nga e cila është disbursuar shuma totale prej 351,009 lekë (344,250 lekë punonjësi dhe 6,759 tarifë përmbarimi). Vlera totale prej **351,009 lekë përbën dëm ekonomik** për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit.

-Janë punësuar 11 punonjës me profesion elektrikistë/elektropompist, pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

- Për procedurën “Rikonstruksioni i rrjetit ujësjiellës të rrugëve nr. 1 “Llazar Bozo”, nr. 2 “Papa Ilija Zagalli”, nr. 3 “Estref Berati”, në lagjen “Kongresi i Lushnjës”, është copëzuar vlera e përllëgaritur e materialeve të ndërtimit, duke i realizuar me procedurë “Blerje të vogël”, duke krijuar shmangie të procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, ku citohet se nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në ligj (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Nuk është zbatuar aktmarrëveshja e datës 27.02.2015 e lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe Shoqërive FMO shpk & I.T.S. shpk dhe Shoqërisë UK Lushnjë, pasi nuk janë instaluar 500 matës elektronik wireless, si dhe 500 saraçineska $\frac{3}{4}$ (20 mm) dhe kundra valvula 500 copë, por janë lënë në ruajtje.

Lënia në ruajtje përbën mos zbatim të marrëveshjes, e cila është kryer në tejkalim të kompetencës nga administratori i shoqërisë A. D., veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statutin e shoqërisë, si dhe rregulloren e brendshme, pasi kjo marrëveshje është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 14.09.2013 dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve nr. 4, datë 25.09.2013, marrëveshje e cila përcakton instalimin e 6,000 matësve. Mos zbatimi i kësaj mosmarrëveshje ka krijuar një dëm ekonomik për shoqërinë UK Lushnjë dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën në vlerën 60,000 euro (*Trajtuar më hollësisht në faqet 81-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/II. “Zgjidhje të kontratës së punësimit”

ose

“Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:

1. S.B., me detyrë përgjegjës i sektorit të shpërndarjes së ujit për periudhën 02.12.2011 dhe në vazhdim.

Për arsye se:

-Prodhimi dhe furnizimi i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, nuk është kryer plotësisht në zbatim të standardeve shtetërore. Konkretisht nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit të pijshëm, si dhe nuk janë kryer analizat të PH të ujit.

-Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka realizuar plotësisht mbrojtjen hijeno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, duke

përcaktuar zonat e mbrojtura nr. 1,2,3, si dhe nuk janë pajisur me një leje nga autoriteti i basenit ujqor vendor, burimet që shfrytëzohen për qëllime të pirjes së ujit.

-Shoqëria "Ujësjiellës Kanalizime" Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e magjistraleve kryesore, dytësore dhe terciare të furnizimit me ujë të pijshëm të cilat duhet të ishin formatuar në rrjetin koordinativ shtetëror, ku të jenë përcaktuar koordinatat përkatëse. Veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 17.05.1984 "Për punimet topogjeodezike dhe hartografike", pika 7, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 07.07.1984 "Për prodhimin, përdorimin dhe shitjen e hartave topografike", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 12.03.2008 "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, përfituar nga fotografimi ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

-Në zbatim të VKM nr. 63, 27.01.2016 dhe ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 510, datë 10.05.2015, prej datës 1 janar 2017 dhe në vazhdim Shoqëria Uk Lushnjë mbulon me shërbimin e furnizimit të ujit dhe largimin e ujërave të ndotura, ish-sha Lushnjë si dhe komunat Dushk, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Karbunar, Fier-Shegan, Allkaj. Nga auditimi u konstatua se për këtë periudhë nuk është kryer klorinimi i ujit të pijshëm.

Veprime në kundërshtim VKM Nr. 145, datë 26.02.1988 "Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 22.02.2007, pika 2 "Kërkesa e cilësisë" ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ".....Uji i dhënë për konsum njerëzor duhet paraprkishtë të dezinfektohet me përjashtim të ujit të ambalazhuar", si dhe Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror", i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.Q. M., me detyrë përgjegjëse i sektorit të KUZ për periudhën 02.12.2011 e në vazhdim.

Për arsye se:

-Në Qytetin e Lushnjës, grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura nuk kryhet plotësisht në magjistralet kryesore, dytësore dhe terciare, por pasi grumbullohet nga shtëpitë, pallatet shumëkatëshe, institucionet dhe bizneset derdhet në kolektorin kryesor (kolektor i hapur) që përshkon qytetin duke filluar nga varrezat publike të qytetit, vazhdon në Komisaratin e Policisë, në shëtitoren kryesore, në shinat e trenit, mes përmes tokave bujqësore deri në kanalet e hapura, duke u derdhur në Detin Adriatik, me një gjatësi të konsiderueshme rreth 4 km brenda qytetit me një sipërfaqe rreth 2.5 km² ose 2,500,000 m², si dhe në kolektorin që përshkon nga Spitali deri kanalën e Lushnjës (kolektor i hapur) në një gjatësi rreth 3 km brenda qytetit, me një sipërfaqe rreth 4.7 km², ose 4,700,000 m², me sipërfaqe totale vetëm brenda Qytetit të Lushnjës 7,200,000 m² ose 720 ha, kolektor me ujëra të ndotura, komerciale dhe industriale që përshkojnë Qytetin e Lushnjës.

Ujërat e ndotura të Qytetit Lushnjë, janë bashkuar me ujërat e shiut, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 26.02.1988 "Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", ndryshuar.

Të dy këto kolektorë, pasi përshkojnë qytetin derdhen në tokat bujqësore (ambient i hapur) duke kaluar në kanalet kulluese të tokës arë, e cila përdoret nga ekonomitë fshatare për kultivimin e bimëve të ndryshme bujqësore, psh sera për prodhim perimesh, grurë misër, kultura foragjere për blegtorinë, pemë frutore, komplekse blegtorale etj, duke prishur të gjithë ekosistemin e zonës.

Në ujërat e ndotura familjare derdhen edhe ujërat e ndotura komerciale dhe industriale si: Fabrika e qumështit, fabrika e konservimit të ushqimit, fabrika e vajit, fabrika e mermerit, pikat e servisit të makinave dhe bojërave, lavazhot e makinave, spitali i qytetit, ambulancat e

qytetit, laboratorët e shëndetit, bujqësor etj, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale.

Të gjitha këto mbetje nuk derdhen në lëndfill apo incineratori apo çdo vend tjetër i përcaktuar me ligj, ku lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve, në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Për pos të sa trajtuar mësipër

Të dy kolektorët e qytetit bashkohen në një kolektor të vetëm, i cili kalon paralel në një distancë rreth 10 m, në vend depozitimit e mbetjeve urbane të Qytetit të Lushnjës (verifikuar nga Gjeoportali për informacionin Gjeohapsinor), me një sipërfaqe rreth 13,500 m², duke përshkruar pastaj të gjithë fushat bujqësore të Myzeqesë duke u derdhur në det.

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë e ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohej për zbatimin e standardeve shtetërore.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industrial), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

-Nga kjo shoqëri, nuk është dërguar asnjë informacion dhe asnjë kërkesë institucioneve kompetente, si dhe organeve drejtuese: si Këshilli Mbikëqyrës (Administrativ) dhe Asambleja e Përgjithshme, në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura dhe ndikimet e tyre në mjedis, me problematikën e përshkruar mësipër, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Në opinionin tonë: Për sa trajtuar mësipër veprimtaria e Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, është veprimtari që shkakton ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut dhe të kafshëve.

Për më tepër substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme që vijnë nga ujërat e ndotura komerciale dhe industriale, janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e një aksidenti madhor dhe duhet të nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”.

Theksojmë se vetëm për 5 vite (2012, 2013, 2014, 2015, 2016), UK Lushnjë ka faturuar nga familjarët, biznesi dhe institucionet publike sasinë **3,562,466 m³** ujë të ndotur **me vlerë 53,462,911 lekë** për grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotur dhe jo vetëm që nuk e ka kryer këtë shërbim edhe pse është paguar nga qytetarët dhe biznesi, por në kundërshtim me dispozitat ligjore të përmendura në këtë procesverbal, ka ndotur ambientin deri në atë masë të ndotjes së ambientit brenda në Qytetin e Lushnjës dhe në të gjithë sipërfaqet e mbjella me bimë bujqësore, pemëtoje, mbashtrim të kafshëve etj të fshatrave përreth, në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis (ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët etj), duke vënë në rrezik shëndetin e njeriut, në rastin e një aksidenti madhor dhe duhet

urgjentisht ti nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin, kufizimin dhe eliminimin e kësaj ndotjeje.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjin nr. 10,431, datë 29.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve Sh.a", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për personat e përmendur më sipër, Administratori i Shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë, mund të aplikoj një nga dy masat e rekomanduara.

C/III "Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate" për:

1. A.P., me detyrë ekonomist i masave shtrënguese dhe i policisë ujore, në departamentin e shitjes për periudhën 21.06.2016 dhe në vazhdim.

2. B.M., me detyrë policë ujorë për periudhën 02.12.2011 e në vazhdim.

3. R.B., me detyrë policë ujorë për periudhën 02.12.2011 e në vazhdim.

Për arsye se;

-në 50 pallate shumëkatëshe vetëm për 32 prej tyre janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, duke paguar detyrimet financiare, ndërsa në 18 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën 540,000 lekë (18 pallate x 30,000 lekë tarifa për pikën e lidhjes).

Për pos sa mësipërm, në këto pallate janë 2,582 apartamente gjithsej, nga të cilat 1,199 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 1,045 apartamente janë pa shitur, në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, 64 apartamente janë të pa shitur por të paguara nga investitorët, ndërsa 274 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8,000 lekë për kontratën. Totali 1139 apartamente x 8000 lekë/kontratë uji = 10,552,000 lekë.

Duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën është në vlerën 10,552,000 lekë

Dëmi ekonomik gjithsej për shoqërinë UK Lushnjë dhe Buxhetin të Shtetit është në **vlerën 11,092,000 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm", i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të

ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në Qytetin e Lushnjë kryejnë aktivitetin e tyre 25 lavazho.

Në 13 prej tyre;

-furnizimi me ujë i tyre kryhet nga magjistrali kryesor i furnizimit të qytetit me ujë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujitë të pijshëm” KREU V, pika 2, 3 dhe 4.

-Nuk janë të pajisura me leje ose autorizimi mjedisore nga Agjencia Rajonale e Mjedisit.

-Nuk ka kontrata për furnizimin me ujë me ujësjellësin, si dhe nuk paguajnë asnjë detyrim për ujin e përdorur.

- Nuk janë të pajisura me lejen e ushtrimit të aktivitetit nga bashkia.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 28.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 (i ndryshuar) “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve” Sh.a, Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 ”Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr,111/2012 “Menaxhimi i burimeve ujore, Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 103-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/IV "Vërejte" për:

1. R. B., me detyrë shefe e departamentit të shitjes për periudhën 09.04.2014 dhe në vazhdim.

2. A. M., me detyrë faturiste

3. H. M., me detyrë faturiste

4. T. T., me detyrë faturiste

5. D. B., me detyrë faturiste

6. Sh. B., me detyrë faturiste

7. E. K., me detyrë faturiste

Për arsye se;

-në 50 pallate shumëkatëshe janë gjithsej 2,582 apartamente nga të cilat 1,199 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 1,045 apartamente janë pa shitur, në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, 64 apartamente janë të pa shitur por të paguara nga investitorët, ndërsa 274 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8,000 lekë për kontratën. Totali 1139 apartamente x 8000 lekë/kontratë uji = 10,552,000 lekë.

Në total detyrimi që nuk i është paguar shoqërisë “Ujësjellës kanalizime” Sh.a Lushnjë është në vlerën **10,552,000** lekë, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime Sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i

ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/V. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, për personat që nuk janë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:

1. A. N., me detyrë ing. i monitorimit dhe mirëmbajtjes në Departamentin e Projekteve dhe Supervizionit, kjo masë është propozuar dhe në auditimin e mëparshëm dhe është larguar nga detyra.

2. L. L., me detyrë ekonomist i masave shtrënguese dhe i policisë ujore, kjo masë është propozuar dhe në auditimin e mëparshëm dhe është larguar nga detyra.

D. Në lidhje me shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga ana e Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të vlerësojë dhe përgatisë materialet përkatëse ose të gjithë materialin që do ti përcillen organit të Prokurorisë, kallëzim penal ose indicie për ekzistencën e elementëve të figurës së veprave penale, të shkeljeve të kryera nga Administratori i shoqërisë dhe/ose drejtues të tjerë të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë.

Shënim 1: Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: K. D., E. V., Sh. A., D. Q., O. Dh., A. M., M. Gj., të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamentit Juridik dhe i Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R